

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike, procesmbajtëse Teuta Spahiu, në lenden penale kundër të akuzuarit N. B., nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-ës, sipas propozim akuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 2739/15 të datës 15.12.2015, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Besim Susuri, dhe të akuzuarit, me date 27.07.2016 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N. B., nga i ati F. dhe e ëma A. me mbiemër të vajzërisë K., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin Zh. – Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 07.09.2015, rreth orës 12:10 min, në rrugën magjistrale P. – V., saktësisht përballë restorant ..., duke shkel ligjin mbi trafikun publik vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve, të markës “VW Passat 351”, ngjyrë të gjelbërt, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, kur arrin në vendin kritik, mënyrën e lëvizjes së automjetit nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjet del jashtë cepit të djathtë të rrugës, automjeti rrotullohet njëherë dhe gjatë këtij veprimi e godet shtyllën reklamuese të restorant ..., me ç’rast me këto veprime përveç dëmeve të shkaktuara materiale, lëndime të lehta trupore pëson bashkëudhëtarja e tij – Sh. B., lëndime këto më për së afërmi të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, dr. V. K., të dhënë me dt. 10.11.2015.

Këso dore ka kryer veprën penale të rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragraf 1 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 3, 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52 dhe 73 të KP-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

E dëmtuara Sh. B. nuk parashtron kërkesë pronësore juridike.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe atë në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 24,44 euro, dhe në emër të ekspertizës të komunikacionit shumë prej 40,88 euro, si dhe të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore në shumë prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar propozim akuzën PP.nr. 2739/15 të datës 15.12.2015, kundër të akuzuarit N. B., nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.3 lidhur me par.1 të KPK-ës,

Prokurori i shtetit Besim Susuri, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.2739/2015 të datës 15.12.2015, kundër të akuzuarit N. B., nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që të merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë.

E dëmtuara Sh. B., nga babai S., dhe nëna Xh., e lindur K., e lindur me datën 07.10.1978, në fshatin Zh., Komuna e Prizrenit, ku edhe jeton, si palë e dëmtuar deklaron që nuk parashtron kërkesë pronësore juridike pasi që të akuzuarin N. B. e ka bashkëshort.

I akuzuari N. B. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranoj veprën penale e cila më vihet në barë, është e vërtetë që unë në ditën kritike kam qenë duke qarkulluar me automjetin e markës Pasat me targa të regjistrimit *numri i targës...*, dhe atë nga drejtimi i P. për në fshatin V., dhe në një moment me të arritur në vendin kritik, ka qenë një sasi e zallit para një ndërmarrjeje e cila merret me punë ndërtimore, dhe aty më ka humbur kontrollin, nuk kam mundur të shmang rrëshqitjen e automjetit tim, nga zalli i cili ishte në rrugë dhe atë në skaje të rrugës, kështu që e kam goditur edhe panon reklamuese të Resturantit Dua të theksoj që paraprakisht unë jam nisur me bashkëshorten time nga fshati Zh. për në Prizren, dhe me të arritur në fshatin Vlashnje, më kanë ftuar me telefon dhe më kanë njoftuar që djali im qenka rrahur në shkollë nga një grup shokësh të tij, andaj si prind menjëherë jam kthyer për të shkuar në shkollën e djalit për të shiquar se çka ka ndodhur konkretisht. Këtë them nga fakti që kam qenë edhe pak i stresuar për fatin e djalit. Andaj, i propozoj gjykatës që të gjitha rrethanat e cekura më lartë, pranimin e fajësisë, që jam person familjar, babai i dy fëmijëve, kjo është hera e parë që kam rra në konflikt me ligjin, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga

veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe propozoj gjykatës që të merre si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 07.09.2015, rreth orës 12:10 min, në rrugën magjistrale P. – V., saktësisht përballë restorant ..., duke shkel ligjin mbi trafikun publik vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa venë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtarëve, të markës “VW Passat 351”, ngjyrë të gjelbërt, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, kur arrin në vendin kritik, mënyrën e lëvizjes së automjetit nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjet del jashtë cepit të djathtë të rrugës, automjeti rrotullohet njëherë dhe gjatë këtij veprimi e godet shtyllën reklamuese të restorant ..., me ç’rast me këto veprime përveç dëmeve të shkaktuara materiale, lëndime të lehta trupore pëson bashkëudhëtarja e tij – Sh. B., lëndime këto më për së afërmi të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, dr. V. K., të dhënë me dt. 10.11.2015.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin kryesor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban propozimi akuzues, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragraf 1 të KP-ës.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë rënduese gjykata gjeti se këtu të dëmtuarit kanë pësuar lëndime trupore, si dhe vet i akuzuari, e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, pendimi i thellë i të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, mosha e të akuzuarit, të njëjtit i ka shokë të punës dhe ka dashur ti dërgoj nëpër shtëpitë e tyre, pasi që kanë qenë orët e vona të natës, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPP-ës.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2098/15 me datë 27.07.2016

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.